



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 161, 162, dhe 163 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kredi Eksportuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria A. G. lidhur me financimin e projektit "Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit".
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 11/79 i datës 20.06.2012, si në vijim:
 - 1.1. Në kolonën me numër rendor 2. të tabelës, ndryshohet shuma nga 225,000.00 (dyqindënjëzetepesë mijë) euro në 220,000.00 (dyqindënjëzet mijë) euro;
 - 1.2. Në kolonën me numër rendor 8. ndryshohet shuma nga 45,000.00 (katër dhjetë e pesëmijë) euro, në 55,000.00 (pesëdhjetepesëmijë) euro;
 - 1.3. Në kolonën me numër rendor 10. ndryshohet shuma nga 30,000.00 (tridhjetëmijë) euro, në 50,000.00 (pesëdhjetëmijë) euro;
 - 1.4. Kolona me numër rendor 18. e tabelës së vendimit Nr. 11/79 fshihet në tërësi.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe Komisioni i Fondit për Kuadro për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/172
Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës për emërim 15 anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës në këtë përbërje:
 - 1.1. Fetah Podvorica;
 - 1.2. Isa Haxhiu;
 - 1.3. Shyqeri Nimani;
 - 1.4. Eda Vulaj;
 - 1.5. Bajram Berisha;
 - 1.6. Naser Sahiti;
 - 1.7. Zymer Neziri;
 - 1.8. Sabile Basha-Keqmezi;
 - 1.9. Husnija Bubuljica;
 - 1.10. Alush Musa;
 - 1.11. Ramadan Zejnullahu;
 - 1.12. Musli Bajraktari;
 - 1.13. Zejnullah Gruda;
 - 1.14. Nexhmi Rexha;
 - 1.15. Radivoje Mançiq.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet nisma e Ministrisë së Financave për negociimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për bashkëpunim dhe lehtësimin e zbatimit të FATCA-së (Partneriteti FATCA - Ligji për pajtueshmërinë e taksave në llogaritë e huaja).
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitat tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë 700,000.00 (shtatëqind mijë) euro për zbatimin e vendimit të Qeverisë Nr. 02/151, të datës 11 tetor 2013.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga programi Shpenzimet e Paparashikuara (Kodi 232-180), kategoria ekonomike Rezerva, dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Departamenti i Thesarit, kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/172

Datë: 27.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2014, mori:

V E N D I M

Për kursimin e 15 % të shpenzimeve në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe komunalit të organizatave buxhetore për vitin 2014

1. Kursehen shpenzimet e organizatave buxhetore në nivelin 15 % të shumës së alokuar nga ndarja buxhetore nga kategoria mallra dhe shërbime dhe komunalit për vitin 2014.
2. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore që pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të identifikojnë vlerën që do të kursehen për çdo nënkategori, konform pikës 1. të këtij vendimi, dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave.
3. Konform njoftimit të bërë nga pika 2. e këtij vendimi, Ministria e Financave obligohet për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë